

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA	
MINISTRIA E DIASPORËS / MINISTRY OF DIASPORA / MINISTARSTVO ZA DIASPORU	
Nënsia Org. Org. Jedlin. Org. Unit:	01
Nr. Prot. Bz. Prot. Prot. No.	163
Nr. / Faqëve Broj. stranic No. pages	
Data. Datum: Date:	27 / 12 / 2011
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Diasporës / Ministarstvo Diaspore / Ministry of Diaspora

Në mbështetje të nenit 93 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4- të Rregullorës nr 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Vendimin e Qeverisë nr 09/15 të datës 18/05/2011 për themelimin e Ministrisë së Diasporës, Rregullores Nr 07/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr 02/2011 , Ligjit mbi Administratën Shtetërore nr.03/L-189.
Ministri I Ministrisë së Diasporës nxjerr këtë:

Udhëzim Administrativ
Për Strukturën Organizative të Ministrisë së Diasporës

Kapitulli I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të përcaktojë strukturën organizative të Ministrisë së Diasporës dhe institucioneve në varësi të saj, si dhe marrëdhëniet ndërsjella ndërmjet aparatit të Ministrisë dhe institucioneve në varësi.

Neni 2

Misioni

Neni 3

Struktura

Me qëllim të ushtrimit sa më efikas të përgjegjësive dhe të funksioneve të saj,
Ministria e Diasporës është e organizuar dhe e strukturuar në:

- 1. Kabineti i Ministrit**
- 2. Sekretari i Përgjithshëm**
- 3. Departamentet, të cilat, në saje të kërkesave dhe të nevojave të punës, përbëhen nga divizionet dhe nga zyrtarët**

-Paraqitja grafike e strukturës organizuese të Ministrisë së Diasporës është dhënë në shtojcën 1, që i është bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Kapitulli II

Organizimi i Kabinetit të Ministrit

1. Kabineti i Ministrit udhëhiqet nga ministri dhe përbëhet nga: ministri, zv.ministrat, këshilltarët politikë dhe nga stafi tjetër mbështetës administrativ.
2. Fushëveprimi, kompetencat dhe përgjegjësitë e Kabinetit të Ministrit janë të përcaktuara me aktet ligjore në fuqi.

Ministri

Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

-U përgjigjet Kryeministrit dhe Kuvendit të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me

Ministrinë.

Zëvendësministrat

-I përgjigjen drejtpërdrejt Ministrit.

Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Këshilltari i lartë politik

-I përgjigjet drejtpërdrejt Ministrit.

Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe mund të ndryshohen me akt të veçantë nga ministri.

Këshilltarët politikë të ministrit

-I përgjigjen drejtpërdrejt Ministrit.

Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe mund të ndryshohen me akt të veçantë nga Ministri.

Shefi i Kabinetit

-I përgjigjet drejtpërdrejt Ministrit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

-Është përgjegjës dhe përkujdeset për tërë dokumentacionin zyrtar dhe për shkresat hyrëse/dalëse për ministrin, duke siguruar përmbushjen e standardeve rigoroze të cilësisë dhe të procedurave;

-Bashkëpunon në mënyrë të gjithanshme me ministrin, duke përfshirë edhe këshilltarët e tij, zëvendësministrat, me qëllim të kryerjes sa më të plotë të punëve dhe të detyrave që janë me interes për ministrin;

-Organizon, i koordinon dhe i administron punët e përgjithshme të personelit në Kabinetin e Ministrit;

-Harton shkresa zyrtare, letra dhe akte të tjera të rëndësishme për ministrin dhe për Ministrinë në përgjithësi;